



Pranimi / Dostizma Prijem / Pristup Received / Delivery	09.01.2024	4	viti god year
Organ / Ujednica Org / Unit	SKUMSHK	135/2024	Sasia Kolicina Quantity
Id Prot Id Prot			112
Shtojca Prilog Appendix			



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1464/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1464/2023, të datës 30.11.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit: Komuna e Leposaviçit, në çështjen juridike-administrative “*ndërprerje e marrëdhënies së punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.01.2024, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *Shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.1464/2023, të datës 30.11.2023, të parashtruar nga ankuesi

II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit për Ankesa në Komunën e Leposaviçit.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 30.11.202, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Aktvendimit të datës 03.11.2023, të Kryetarit të Komunës së Leposaviçit, për përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, me pretendimet ankimore që punëdhënësi ka marrë aspekte krejtësisht të paligjshme lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat materiale lidhur me çështjen, konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesi në bazë të kontratës së punës, të datës 30.11.2020, mbanë pozitën e punës “*Shef i Ndërrimit*” në kuadër të Njësisë Zjarrfikëse, në Komunën e Leposaviçit.

Me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë përkatësisht me nenin 5 paragrafin 1 të këtij ligji, është përcaktuar se: “*Kategoritë e zyrtarëve/it publik janë: 1.1. Nëpunësja/i i shërbimit civil; 1.2. Nëpunësja/i i shërbimit publik; 1.3. Krijuesja/i dhe performuesja/i e/i artit dhe kulturës; 1.4. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës; dhe 1.5. Zyrtarja/i i kabinetit. 2. Nëpunësja/i i shërbimit civil është zyrtarja/i publik në kuadër të shërbimit civil i cili merr pjesë në formulimin dhe/apo zbatimin e politikave,*

monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme profesionale dhe administrative në zbatim. Nëpunësja/i i shërbimit civil ushtron detyrën në pozitën përkatëse, duke filluar nga zyrtarja/i profesional deri në pozitën e drejtueses/it të lartë, në administratën e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në Zyrën e Kryeministres/it të Republikës së Kosovës, në Ministri, në Agjenci Ekzekutive dhe në degë lokale të tyre, institucione të pavarura kushtetuese, në agjenci të pavarura dhe rregullatore, në administratën komunale dhe çdo nëpunëse/ës statusi i të cilit është përcaktuar si nëpunëse/ës i shërbimit civil, me ligj të veçantë. 3. Nëpunësja/i i shërbimit publik është zyrtarja/i publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. Nëpunësja/i i shërbimit publik ushtron detyrën në pozitën përkatëse duke filluar nga niveli profesional deri në nivelin e lartë drejtues. Nëpunësja/i i shërbimit publik është edhe nëpunësja/i i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publ”, rrjedhimisht, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në Kontratën e Punës se ankuesit (të datës 30.11.2020) sipas të cilës ankuesi ka themeluar marrëdhënie të punës me Komunën e Leposaviqit mbi bazën e Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Kolegji i Këshillit konstatoi se pozita e punës së ankuesit “Shef i Ndërrimit” në kuadër të Njësisë Zjarrfikëse në Komunën e Leposaviqit, është pozitë e nëpunësit të shërbimit publik, kështu që, në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit pasi që ankuesi nuk e ka pozitën e nëpunësit civil.

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji duke u bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë , si dhe nenin 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, thekson faktin se **nëpunësit e shërbimit publik**, fillimisht duhet të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Marrë parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, Kolegji duke u bazuar në nenin 75 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi që lënda ti dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa në Komunën e Leposaviqit.


Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitivin të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1464/2023

Ardita Perçuku-SHYTI


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Komisionit për Ankesa në Komunën e Leposaviqit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Leposaviqit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

